



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 62, datë 24.04.2019

**PËR
DËRGIMIN E EMRAVE TË KANDIDATËVE TË CILËT KANË APLIKUAR PËR T’U
KOMANDUAR NË POZICIONIN E PEDAGOGUT TË BRENDSHËM NË SHKOLLËN
E MAGJISTRATURËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 264 dhe 265 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e tij nr.33, datë 19.02.2019, si dhe pas vlerësimit të kërkesave të gjyqtarëve znj. Tereza Lani dhe z. Altin Shkurti,

V E N D O S I:

1. T’i dërgohen Shkollës së Magjistraturës emrat e znj. Tereza Lani (Merkaj) dhe z. Altin Shkurti, të cilët kanë aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej tyre.
2. Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR